

Plagoset me armë zjarri një person në Nashec të Prizrenit



18/05/2024 08:30



Një person është plagosur me armë zjarri në mbrëmjen e së premtes në fshatin Nashec të Prizrenit.

Rastin e ka konfirmuar zëdhënësi i Policisë së Kosovës për rajonin e Prizrenit, Vesel Gashi.

Gashi potencoi se rasti ka ndodhur në fshatin Nashec të Prizrenit, ku dyshohet se i dyshuari ka gjuajtur nga automjeti duke lëvizur në automjetin e viktimës.

Ai theksoi se viktima është dërguar fillimisht në emergjencën e spitalit rajonal të Prizrenit, ndërsa shtoi se është jashtë rrezikut për jetë.

"Me datë: 17.05.2024 rreth orës 19:45, stacioni policor Prizren ka pranua informatë se në Emergjencën e Spitalit Rajonal Prizren rreth orës 18:20 është sjellë një person i plagosur me armë zjarri. Pas marrjes së informatës Policia menjëherë i'u ka përgjigj rastit, ka shkuar në spital dhe sipas informatave te para viktima është JA", u shpreh Gashi.

Ai shtoi se i dyshuari është larguar nga vendi i ngjarjes.

"Viti i lindjes 1987, nga fshati Korishë e Prizrenit. Ndërsa i dyshuari i cili është larguar nga vendi i ngjarjes është po ashtu nga fshati Korishë dhe bëhët fjalë për personin B.U. Viktima është plagosur në këmbën e djathtë dhe ëshë jashtë rrezikut për jetë, sipas mjekëve nga emergjenca e spitalit rajonal në Prizren".

Ai potencoi se njësitet policore janë në kërkim të të dyshuarit.

Më shumë nga uebi

nativeGRAM



Artikuj të ngjashëm



May 18, 2024

Bënin gara të shpejtësisë: Gjobiten me nga 500 euro dy persona në Gjakovë



May 18, 2024

Kurti bëri fushatë për koalicionin VLEN, kryetari i Gjilanit viziton Talat...




May 18, 2024

Hovenier viziton Komandën Rajonale të KFOR-it-Lindje



May 18, 2024

Haziri: Kurti s'po guxon ta dërgojë Draftin e Asociacionit në Kushtetuese...



May 18, 2024

Këshilltari i Bislimit: Serbia mëton e lirë, Kosova po ndëshkohet kohë...



May 18, 2024

Komandanti i KFOR-it: Shtuam prezencën e trupa paqeruajtëse për mbi 1000...



Other Links